



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 244/2 Prot

Tiranë, më 24.05.2023

V E N D I M

Nr. 34, datë 24.05.2023

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore dhe lirimit të nëpunëses *** nga shërbimi civil.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes mbi trajtimin e informacionit,

VËREJ SE:

Në informacionin e regjistruar me nr. 244 prot., datë 28.02.2023, nëpunësja ***** pretendon për parregullsi të kryera në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, si në aspektin e respektimit të procedurës disiplinore të nisur ndaj saj, ashtu edhe në procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet se punonjësja ***** është emëruar sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni për shërbimn civil, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës”, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Kulturës.

Shkaku i fillimit të këtij procesi verifikimi, lidhet me faktin se Drejtoresha e Përgjithshme Ekonomike, në cilësinë e eprorit direkt, në ushtrim të funksioneve të saj drejtuese dhe

organizuese, ka kontrolluar veprimtarinë e nëpunëses ***** në lidhje me kryerjen/zbatimin e detyrave të saj funksionale, sidomos në lidhje me likuidimin e disa faturave, në përfundim të të cilit, ndër të tjera ka konstatuar mosrespektim të afateve të caktuara në shlyerjen e tyre; mungesë bashkëpunimi në mënyrë të përsëritur me kolegët; largim nga vendi i punës, pa njoftuar më parë eprorin, etj.

Duke qenë se shkeljet e konstatuara shoqëroheshin dhe me dëm ekonomiko-financiar, eprori direkt ka arritur në përfundimin se shkeljet e konstatuara ishin të natyrës “shumë të rënda”, prandaj mbështetur në pikën 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në pikën 2, kreu II, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore dhe ndjekjen e problemit nga ana e Komisionit Disiplinor, bazuar në pikën 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pas kësaj Komisioni i Disiplinës, me shkresën nr. 121/3 prot., datë 17.01.2023 “Njoftohet nisja e ecurisë disiplinore dhe mbledhja e Komisionit Disiplinor”, ka vënë në dijeni nëpunësen e proceduar për sa më sipër, duke i bërë të ditur njëherësh, të drejtën e saj për të paraqitur sqarimet rreth shkeljeve të pretenduara, të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues, si dhe datën e shqyrtimit në seancë dëgjimore.

Në vijim, siç rezulton nga përmbajtja e procesverbaleve të Komisionit Disiplinor (procesverbal nr. 121/7 prot., datë 25.01.2022 dhe nr. 121/10 prot., datë 16.02.2023), palët janë paraqitur në seancë dëgjimore, duke paraqitur me shkrim edhe pretendimet e tyre mbi procesin që po zhvillohej.

Në seancën e datës 25.01.2022, Komisioni Disiplinor, nisur nga bindja se nëpunësja e proceduar mund të ndikonte në pengimin e hetimit administrativ, si dhe në kushtet kur mund të çenohej ushtrimi i përshtatshëm i detyrës, me vendimin e ndërmjetëm nr. 1, datë 25.01.2023, ka vendosur pezullimin e saj nga ushtrimi i detyrës deri në përfundim të hetimit administrativ dhe marrjen e vendimit.

Pretendimi kryesor i paraqitur nga nëpunësja e proceduar lidhej me arsyetimin se ajo nuk duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore për shkeljet e konstatuara, pasi nuk është “nëpunës zbatues”, pretendim i cili nuk mund të merret në konsideratë, pasi në bazë të pikës 24, të nenit 4, të ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar” i ndryshuar, “nëpunës zbatues” është një nëpunës i nivelit menaxherial të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë. Duke mbajtur parasysh detyrën e saj si “Përgjegjëse e Sektorit të Financës”, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, është e kuptueshme që sipas ndarjes së brendshme të punëve, njësia e saj organizative kishte detyrat e veta për të cilat

mbante përgjegjësi personale. Nëse nuk ka funksionuar si duhet kjo hallkë administrative që drejtohej nga nëpunësja *****, mund të ngarkojë me përgjegjësi indirekte ata drejtues që nuk kanë organizuar dhe ushtruar kontrollin e duhur të kësaj njësie organizative, por nuk mund ta shkarkojë atë nga përgjegjësia direkte.

Në përfundim të procedurës disiplinore, pasi janë marrë në shqyrtim si materialet që evidentonin shkeljet e pretenduara, ashtu dhe prapësimet e nëpunëses së proceduar, bazuar në parimin e përshkallëzimit, Komisioni Disiplinor ka arritur në konkluzionin se shkeljet e kryera klasifikoheshin si “shkelje të rënda”, të parashikuara në pikën 3 (germa “a” dhe “ç”), të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Për këtë arsye, në mbështetje të përcaktimeve të pikës 4, në nenin 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas të cilit, *për shkeljet e rënda të parashikuara në pikën 3, të nenit 57, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “b” ose “ç” të nenit 58, të këtij ligji*, Komisioni Disiplinor me vendimin e tij nr. 2 dt. 17.2023, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 1 (një) vjeçare”, për nëpunësen *****.

Konstatohet se, ndërkohë që Komisioni Disiplinor kishte nisur dhe zhvillonte procedimin disiplinor në ngarkim të nëpunëses *****; kjo e fundit, mbështetur në nenin 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka paraqitur përpara njësisë së burimeve njerëzore (Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse), kërkesën për dorëheqje (nr.377 prot., datë 26.01.2023 “Kërkesë për dorëheqje”).

Drejtori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse, mbi bazën e kërkesës së nëpunëses, mbështetur në përcaktimet e nenit 66 (pika 1/dh dhe pika 4/a), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; si dhe në pikën 21, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, me vendimin nr. 377/1 prot., datë 17.02.2023 “Për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses *****; Përgjegjës në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar”, ka miratuar dorëheqjen duke vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet lirim nga shërbimi civil, për nëpunësen *****; veprim administrativ të cilin ajo e ka pranuar.

Megjithatë, ajo ka parashtruar pretendimin tjetër se bashkë me vendimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe lirim nga detyra duhej të ishte vendosur edhe pagimi i pjesës së mbetur të lejes vjetore të pakryer për vitin 2022.

Nga verifikimi i këtij pretendimi ka rezultuar se nëpunësja *****; për vitin 2022, ka konsumuar 14 ditë nga 28 ditë kalendarike të lejes vjetore, duke lënë pa kryer 14 ditë të tjera (shih përmbajtjen e e shkresës (Vërtetim) nr. 1702 prot, datë 06.04.2023).

Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të dorëheqjes, kryer me aktin (Vendim) nr. 377/1 prot., datë 17.02.2023, ashtu siç përcaktohet në pikën 8, të Kreut III, të Vendimit nr. 568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë, etj. ”, duhej të ishte shoqëruar edhe me pagesën e pjesës së lejes së pakryer për vitin 2022, si dhe pjesa e lejes takuese për periudhën 1 janar-17 shkurt 2023.

Nga gjithë sa u parashtrua, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohen veprimet si më sipër, arrihet në konkluzionin se, ndërsa veprimet administrative të Komisionit Disiplinor konsiderohen të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil e për këtë pjesë të veprimtarisë administrative duhet vendosur përfundimi i procesit të verifikimit dhe arkivimi i çështjes, për mospagimin e pjesës së mbetur të lejes vjetore, duhet të urdhërohet plotësimi i aktit të lirimit, sipas përshkrimit në pjesën e mësipërme të relacionit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të ecursisë disiplinore dhe vendimit nr. 2, dt. 17.02.2023, të Komisionit Disiplinor për “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 1 (një) vjeçare”, për nëpunësen ***** dhe, meqënëse në veprimet e mësipërme nuk gjenden elemente të kundraligjshëm, arkivimin e çështjes.
2. Të plotësohet akti (Vendim) nr. 377/1 prot., datë 17.02.2023, i Drejtorit të Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, me detyrimin për pagimin e nëpunëses ***** , për pjesën e pakryer të lejes vjetore të vitit 2022 dhe periudhën Janar-Shkurt të vitit 2023.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani e vendimit.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer

ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.

5. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha